**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 1/1;

c. Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;

ç Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

dh. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 8;

e. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9 ;

f. Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo në proces sipas Shtojcës 10;

g. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

h. Sigurimin e ofertës lëshuar nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente, i cili duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas Shtojcës Nr.11 pika 1 Kriteret e Përgjithshme të Pranimi/Kualifikimit.

### 2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancin) gjatë tre viteve të fundit (2018, 2019, 2020) të certifikuar nga organet tatimore.

b) Xhiroja vjetore mesatare e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2018, 2019, 2020) të jetë jo më pak se 50% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose dokument i lëshuar online me vulë elektronike.

c) Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore të Vitit 2020 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar), për të cilat duhet të paraqesë një vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

d) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

- Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.



## Dokumenta Standarde të Tenderit

- Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.
- Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë;

Për kontrata për punë publike të realizuara me institucione shtetërore kërkohen:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes,
- Situacion përfundimtare të objektit,
- Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojces nr.9,

Për kontrata për punë publike të realizuara me subjekte private kërkohen:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes,
- Situacion përfundimtare të objektit,
- Faturat tatimore shitje për çdo situacion.

### 2.3 Për kapacitetin teknik:

**2.3.1** Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zoterojë Liçenca Profesionale të lëshuar nga institucionet shtetërore të autorizuar me ligj si më poshtë:

- NP -3 A Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale
- NS -1 A Punime për prishjen e ndërtimeve
- NS -4 A Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to etj

**2.3.2.** Operatori ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i operatorit ekonomik ofertues), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Librezë pune (përkatëse)
- c) Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- d) Diplomë

**2.3.3.** Operatori ekonomik ofertues për realizimin e kontratës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesën e subjektit, specialistët si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier **Ndërtimi**; (kontratë pune e vlefshme, diplomë, liçencë nëse ka të tillë) Inxhinieri i ndërtimit duhet të jetë drejtues teknik i shoqërisë.
- 1 (një) Inxhinier **Mekanik** (kontratë pune e vlefshme, diplomë, liçencë nëse ka të tillë).

**2.3.4** Një punësim mesatar i të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) punonjësve për periudhën Janar 2021 -Mars 2021 të vërtetuar me dokumentacionin si vijon;

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Janar 2021 -Mars 2021.

**b.** Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2021 -Mars 2021.

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar, minimumi 5 (pesë) punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- 2 (dy) Punonjës specialist ndërtimi me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të akredituara.
- 1 (një) Punonjës mekanik me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të akredituara.
- 2 (dy) Punonjës specialistë hidroizolimi me kualifikime teknike lëshuar nga institucione të akredituara.

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës në formatin e përcaktuar nga ligji e vlefshme dhe dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik nga institucione të akredituara.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit të cilat përfshijnë objektin e prokurimit. Çertifikatat që kërkohen duhet të jenë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

- ❖ Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën **ISO 9001:2015** ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
- ❖ Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën **ISO 14001:2015** ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
- ❖ Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën **ISO 45001:2018** ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
- ❖ Organi i vlerësimit të konformitetit të çertifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

**2.3.7** Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, për materialet 1.Llaç i gatshëm suvatimi, 2.Çimento, 3.Katrama, 4.Llamarinë zingato 5.Hekur betoni, 6.Polisterol, (të paraqitura në Shtojcën 12, Specifikimet Teknike), operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesit, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo produkti me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi për të cilat kërkohen standarte kombëtare ose ndërkombëtare të publikuara (të pasqyruara në Shtojcën Nr.12 Specifikimet Teknike), duhet të paraqesë certifikatë/deklaratë konfirmimit CE të prodhuesit të konfirmuar nga një organizëm i notifikuar european/organizëm certifikues i akredituar ose raportet e testimit nga organizëm i notifikuar european/laboratorë testimi të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara.

**2.3.9** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacion për posedimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike në pronësi ose me qira, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Nr.	Mjetet	Sasia minimale	Gjendja
1	Kamion me vinç	1 copë	Ne pronesi ose me qera
2	Pompë uji	1 copë	Ne pronesi ose me qera
3	Matrapik	1 copë	Ne pronesi ose me qera
4	Kamionçinë 3.5 -5ton	2 copë	Ne pronesi ose me qera
5	Skeleri metalike	200 m2	Ne pronesi ose me qera
6	Vinç karel $\geq 0.5$ ton	1 copë	Ne pronesi ose me qera
7	Gjenerator $\geq 5$ kw	1 copë	Ne pronesi ose me qera
8	Depozitë uji 1000-3000lt	1 copë	Ne pronesi ose me qera
9	Helmetë mbrojtëse për kokën	15 cope	Ne pronesi ose me qera
10	Jelekë me shirita fosforishentë	15 cope	Ne pronesi ose me qera
11	Fikse Zjarri të lëvizshme min. 5kg	8 cope	Ne pronesi ose me qera
12	Tabela Sigurimi Teknik	20 cope	Ne pronesi ose me qera
13	Kuti e Ndihmës së shpejtë	10 cope	Ne pronesi ose me qera

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), certifikatë pronësie e automjetit dhe leje transporti kurse për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, certifikatë pronësie e automjetit dhe leje transporti (*të vlefshme*) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin automjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- c) Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes, si edhe foto të mjeteve dhe kur ato janë të marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e e qiradhënësit si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe foto të mjeteve.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- d)** Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë brenda orarit të punës, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas Shtojcës Nr.9. *(Duhet të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese që pranon kërkesën e bërë nga autoriteti kontraktor për këtë pikë).*

*(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## Shtojca 12

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

#### **Përshkrim i punëve:**

##### **Prishje shtrese hidroizoluese**

Duhen prishur shtresa horizontale hidroizoluese të taracës me zhvillime vertikale, edhe në praninë e oxhaqeve, e ndërtuar nga tre shtresa të mbivendosura katramaje, duke përfshirë heqjen e kapakëve të parapetit e të çdo pjesë metalike dhe vënien mënjanë dhe spostimin në kantir të materialeve që formohen si dhe çdo detyrim tjetër për të përfunduar plotësisht heqjen e materialve ekzistuese të taracës pasi është dëmtuar në një mënyrë të pariparueshme. Është e nevojshme prishja e suvasë të paktën në një lartësi prej 30cm, deri në dalje në dukje të muraturës, e nevojshme për vendosjen e guainës.

##### **Prishje suvatimi**

Prishja e suvatimit bëhet në vendet ku suvaja është dëmtuar në mënyrë të pakthyeshme. Përpara dhe gjatë prishjes bëhet lagja e herëpashershme me qëllim eliminimin e pluhurave.

##### **Suva e zakonshme fasade mur tulle**

Ne muret e brendeshme që kishin kontakte me ambientin e jashtëm si rezultat i prishjes të hidroizolimit të terraces u konstatua fenomeni i lageshtisë së tyre, për këtë fenomen duhet nderhyrja në suvatimin e mureve të jashtëm të fasades dhe zëvendësimin e disa ulluqeve që shkaktojnë lageshtirën e mureve. Stukim dhe sistemim i sipërfaqeve ku është e nevojshme, për suvatime për nivelimet e parregullsisë, me anë të mbushjes me llaç bastard me më shumë shtresa dhe copa tullash n.q.s është e nevojshme, edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht stukimin. Përpara se të hidhet sprucimi duhet që sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë. Sprucim i mureve dhe tavaneve për muraturë të pastruar me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin. Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi i Standartit Shqiptar SSH EN 998-1:2016 ose ekuivalent, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirtit me llaç me gjerësi 15 cm çdo 1 deri në 1.5 m), dhe e lëmuar me mistri e bërda, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

### **Hidroizolim me emulsion bituminoz 2/k katrama**

Tarracat e godinave kane nevojë për hidroizolim me emulsion bituminoz dhe 2 k katrama për shkak të demtimit të saj që ka sjelle si pasojë lageshtirë në ambientet e brendshme të kateve të fundit të godinave.

Procesi i hidroizolimit të taraces do të kryhet në vendet e demtuara ku ka lageshti dhe rrjedhje. Përpara fillimit të procesit të hidroizolimit duhet që: sipërfaqja të jetë e thatë, e pastruar, e niveluar me parë si në pjesët horizontale ashtu dhe në ato vertikale. Kujdes të veçantë t'i kushtohet lidhjes së mbulesës me elementet e parapeteve për të eliminuar lageshtinë si dhe zëvendësimin e parapeteve të hequra. Sistemim i planit aktual të pjerresive për pjesët e prishura, duke përdorur llaç çimentoje m 1:2, mbi të cilën do të realizohet: një shtresë llaç çimento me trashësi minimale 2 cm, e niveluar në mënyrë perfekte për përgatitjen e sipërfaqes ku do të vihet hidro-izoluesi. Riberje e shtresës së suvatimit vertikal, e niveluar për vendosjen e guaines. Shtresë hidro-izoluese, mbi sipërfaqe të thatë dhe të niveluar si me sipër, duke përfshirë pjesën vertikale, trajtuar me një dorë praimer, e përbërë nga dy membrana guaine të formuar nga një shtresë fibre prej leshi xhami e bitumi, me trashësi 3 mm secila, të vendosura në vepe me flake, të kryqezuara mbi sipërfaqe të rrafshet, të pjerret ose vertikale, deri poshtë kopertines, përfshirë mbivendosjen e lidhjeve (minimumi prej 12 cm), punët e perkohshme për të gjithë kohezgjatjen e punës, e përbërë nga struktura druri ose hekuri dhe sipër saj me një pelhurë të papershkrueshme ose të ngjashme për mbrojtjen nga shiu, që do të aplikohet në sipërfaqen mbi të cilën po punohet, si dhe heqjet, spostimet, mberthimet etj., si dhe çdo detyrim tjetër të nevojshëm për të dhënë fund punës në mënyrë perfekte.

### **Vendosje ulluk shkarkimi vertikal xingato**

Duhet zëvendësuar ulluqet shkarkimi vertikal me llamarinë xingato të demtuara në sipërfaqet e fasadave të godinave. Ulluket janë për shkarkimin e ujrave të taracave, dhe kur janë në gjendje jo të mirë duhet të çmontohen dhe të zëvendësohen me ullukë të rinj. Ulluqet vertikale për shkarkimin e ujrave të tarracave që përgatiten me llamarinë prej çeliku të xinguar, duhet të kenë trashësi jo më të vogël se 0.6 mm dhe diametër 10 cm. Në çdo ulluk duhet të mblidhen ujrat e një sipërfaqe tarrace.

### **Grafiku i Punimeve:**

Sipas kërkesave të autoritetit kontraktor dhe do të pasqyrohet në kontratë me marrëveshje ndërmjet palëve kontraktuese.

### **Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

Të gjitha mallrat e nevojshme për kryerjen e punimeve të parashikuara duhet të përmbushin standartet Europiane të konformitetit sipas normativave CE.

Punimet do të kryhen nga operatori ekonomik me cilësi dhe garanci teknike të cilat do të përcaktohet në kushtet e veçanta dhe të përgjithshme të kontratës.

## **Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:**

### **1.Llaç i gatshëm suvatimi**

Llaç i gatshëm të jetë i prodhuar specifikisht si material mbushës për mure tulle ose blloqe betoni, për ambiente të brendshme ose të jashtme, përbërja e të cilit të jetë në formë pluhuri me bazë çimento, gëlqere, rërë guri, rezina sintetike dhe aditiv. Gjatë aplikimit temperatura e ambientit duhet të jetë +5<sup>0</sup>C - +35<sup>0</sup>C.

#### **KARAKTERISTIKAT TEKNIKE:**

- Natyra e lidhësit: çimento, gëlqere, rërë guri, rezina sintetike dhe aditiv.
- Ngjyra: Gri
- Konsumi: >1.2 kg/m<sup>2</sup>
- Peshë specifike: 1.6 -1.9 gr/cm<sup>3</sup>
- Madhësia e korrozave: ≤ 1.2mm
- Rezistenca në shtypje (pas 28 ditësh): ≥ 3 Mpa
- Magazinimi: Në temperatura në intervalin + 5<sup>0</sup>C - +30<sup>0</sup>C në ambient të thatë
- Jetëgjatësia: jo më pak se 1 vit
- Paketimi: Në thasë 20-40 kg

#### **STANDARTET QË DUHET TË PËRMBUSHË:**

- Standartin Shqiptar SSH EN 998-1:2016 ose ekuivalentin e tij.

### **2.Çimento 42.5R**

Çimento është një lidhës hidraulik, i një material inorganik i bluar imtësisht, i cili kur përziehet me ujë, formon një pastë e cila vendoset dhe forcohet mes efektit të proceseve të reaksionit hidrik, të cilat pas forcimit, mbajnë forcën dhe stabilitetin edhe nën ujë. Çimentoja kur paktohet mirë dhe përziehet me agregat dhe ujë, është në gjendje të prodhojë beton ose llaç, të cilët e ruajnë aftësinë për t'u modeluar e punuar për një kohë të mjaftueshme dhe janë në gjendje që pas një kohe të përcaktuar, të përftojnë nivelet e specifikuara të fortësisë dhe të stabilitetit afatgjatë të volumit.

#### **KARAKTERISTIKAT TEKNIKE:**

- Klinker: ≥ 80%
- Gur gëlqeror: ≤ 20%
- Përbërës dytësor: ≤ 5%
- Koha e fillimit të mpikjes: ≥ 60 min
- Zgjerimi (qëndrueshmëria): ≤ 10mm
- Rezistenca në shtypje (pas 2 ditësh): ≥ 20 Mpa
- Magazinimi: Në temperatura në intervalin + 50<sup>0</sup>C - +30<sup>0</sup>C në ambient të thatë
- Jetëgjatësia: jo më pak se 1 vit
- Paketimi: Në thasë 20-40 kg

#### **STANDARTET QË DUHET TË PËRMBUSHË:**

- Standartin Shqiptar SSH EN 197-1:2011 ose ekuivalentin e tij.

### 3.Katrama

Membranë bituminoze plastomerike të jetë e bazuar në një përzierje të bitumeve të distiluara dhe polimereve termoplastike (APP, IPP) të cilësisë së lartë. Membrana të jetë e përforcuar me pëlhurë poliestre pa thurje (min. 160 g/m<sup>2</sup>). Sipërfaqja e sipërme e membranës nën sipërfaqe të ketë një shtresë të hollë polietileni që mund të shkrihet lehtësisht me pajisje ngrohëse (kanellë/torçë). Të ketë një fortësi të shkëlqyer dhe të sigurojë hidroizolim të plotë të ujit.

#### KARAKTERISTIKAT TEKNIKE:

- Pesha:  $\geq 4,0 \text{ kg/m}^2$
- Rezistenca në tërheqje (gjatësore):  $\geq 700 \text{ N} / 5 \text{ cm}$
- Rezistenca në tërheqje (tërthore):  $\geq 500 \text{ N} / 5 \text{ cm}$
- Zgjatimi deri në këputje (gjatësor):  $\geq 40 \%$
- Zgjatimi deri në këputje (tërthor):  $\geq 40 \%$
- Rezistenca deri në daljen e pikës së ujit (gjatësore):  $\geq 140 \text{ N}$
- Rezistenca deri në daljen e pikës së ujit (tërthore):  $\geq 180 \text{ N}$
- Rezistenca ndaj shpimit statik:  $\geq 3 \text{ L}$
- Rezistenca ndaj shpimit dinamik:  $\geq 4 \text{ L}$
- Fleksibiliteti ndaj të ftohtit:  $\geq -5^\circ\text{C}$
- Rezistenca ndaj të nxehtit:  $+120^\circ\text{C}$  Pika e zbutjes:  $> +150^\circ\text{C}$
- Depërtimi në  $+250^\circ\text{C}$ :  $25 \pm 5 \text{ dmm}$

#### STANDARTET QË DUHET TË PËRMBUSHË:

- Standartet Shqiptare SSH EN 13707:2013 dhe SSH EN 13969:2004/A1:2006 ose ekuivalentet e tyre.

### 4.Llamarinë e galvanizuar (xingato)

Përshkrim i produktit: Llamarina e galvanizuar përdoren për formimin në të ftohtë duke u përkulur dhe profilizuar. Çeliku të jetë i galvanizuar me të nxehtë në shkallën jo më pak se DX51D dhe të jetë fabrikuar sipas Standartit Shqiptar SSH EN 10346 ose ekuivalentin e tij. Trashësia e veshjes së zinkut ndryshon në varësi të kërkesave dhe natyrës së përdorimit.

#### KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

- Përbërja kimike: Çelik i galvanizuar në të nxehtë
- Trashësia (spesori):  $\geq 0.6\text{mm}$
- Forca në tërheqje:  $\geq 270 \text{ Mpa}$
- Pesha specifike e veshjes nga të dyja krahët:  $\geq 100 \text{ gr/m}^2$
- Trashësia e veshjes:  $\geq 10\mu\text{m}$
- Zgjatja A80:  $\geq 20 \%$
- Magazinimi: në ambient të thatë

#### STANDARTET QË DUHET TË PËRMBUSHË:

- Standartin Shqiptar SSH EN 10346:2015 ose ekuivalentin e tij.



## 5.Hekur për beton Ø10mm

Shufrat e hekurit për përforcimin e betonit prodhohen nga procesi i temperimit me uje dhe i petezimit ne te nxehte ne perputhje me standartet ASTM, DIN, BS, TS, GOST dhe te gjitha standartet e tjera boterore. Shufrat e hekurit përdoren për të ndihmuar beton të përballojë forcat e tensionit. Betoni është mjaft i fortë për forcat e ngjeshjes nga natyra, por forcat e tensionit mund ta dëmtojnë atë. Përdoren per ndertesa banimi dhe industriale.

### KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

- Grada e përforcimit të çelikut:  $\geq$  B500C
- Diametri nominal: 10 mm
- Forca në shtypje:  $\geq$  500 N/mm<sup>2</sup>
- Forca në tërheqje:  $\geq$  550 N/mm<sup>2</sup>
- Peshë specifike:  $\geq$  0.6  $\pm$  5% kg/m
- Zgjatja 10d:  $\geq$  10%
- Magazinimi: në ambient të thatë

### STANDARTET QË DUHET TË PËRMBUSHË:

- Standartin Shqiptar SSH EN 10080:2005 ose ekuivalentin e tij.

## 6.Polisterol 100mm-200mm

Pllaka termoizoluese nga polistireni i zgjeruar (EPS) për përdorim në fasadat e ndërtesave për sisteme të përbërë të izolimit termik të jashtëm (ETICS). Është polisterol termoizolues me ngjyrë të bardhë prej polisteroli vetëshues. Përdoret në ndërtim për termoizolim të fasadave, por mund të përdoret edhe për izolim mes mureve etj. Ofron rezistencë të lartë në shtypje dhe është rezistent ndaj thithjes së lagështisë.

### KARAKTERISTIKAT TEKNIKE:

- Trashësia: 100-200mm
- Peshë specifike:  $\geq$  20 kg/m<sup>3</sup>
- Përçueshmëria termike ( $\lambda$ D):  $\leq$  0.035 W/(m\*k)
- Rezistenca në shtypje me ngjeshje 10%:  $\geq$  100 kPa

### STANDARTET QË DUHET TË PËRMBUSHË:

- Standartin Shqiptar SSH EN 13163:2012 + A2:2016 ose ekuivalentin e tij.

**Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara**

### KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

**Shtojca 13**

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

**PREVENTIVAT E PUNIMEVE**

Nr.	Nr. Manual/Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi pa tvsh	Vlera gjithsej pa tvsh
<b>1</b>		<b>SHKOLLA "28 NËNTORI"</b>				
<b>I</b>		<b>PUNIME PRISHJE</b>				
1	An	Prishje shtrese pllake	m <sup>2</sup>	453		
2	An	Prishje shtrese h/izolimi	m <sup>2</sup>	453		
3	An	Prishje suva muri parapeti	m <sup>2</sup>	60		
4	2.37/3b	Transport materiale ndërtimi me auto deri 8 km	m <sup>3</sup>	50		
<b>II</b>		<b>PUNIME BETONI+ SUVATIMI</b>				
1	2.331	Suva brenda mur tulle parapeti	m <sup>2</sup>	60		
2	1.29/1	Mure b/a C16/20	m <sup>3</sup>	0.8		
3	2.166	Hekur betoni Ø10mm	ton	0.1		
<b>III</b>		<b>PUNIME SHITESASH</b>				
1	2.264	Shtresë llustër çimento	m <sup>2</sup>	906		
2	2.197	H/izolim tarace 2/kk	m <sup>2</sup>	513		
3	2.200/1	Termoizolim solete 10-20cm me polisterol	m <sup>2</sup>	453		
4	An	Polisterol për fugë	m <sup>3</sup>	1		
5	2.203	Veshje kornize me llamarinë xingato	m <sup>2</sup>	15		
6	2.209/a	Ulluk shkarkimi PVC Ø120mm	ml	40		
7	An	F.V varanga	copë	5		
		<b>Shuma 1 (I-III)</b>				
<b>2</b>		<b>SHKOLLA "GJON BUZUKU"</b>				
<b>I</b>		<b>PUNIME PRISHJE</b>				
1	An	Prishje shtrese h/izolimi	m <sup>2</sup>	356		
2	2.37/3b	Transport materiale ndërtimi me auto deri 8 km	m <sup>3</sup>	15		
<b>II</b>		<b>PUNIME SHITESASH</b>				
1	2.264	Shtresë llustër çimento	m <sup>2</sup>	712		
2	2.197	H/izolim tarace 2/kk	m <sup>2</sup>	380		
3	2.200/1	Termoizolim solete 10-20cm me polisterol	m <sup>2</sup>	453		
4	2.203	Veshje kornize me llamarinë xingato	m <sup>2</sup>	45		
		<b>Shuma 2 (I-II)</b>				

Dokumenta Standarde të Tenderit

<b>3</b>		<b>SHKOLLA "IBRAHIM HASMEMA"</b>				
<b>I</b>		<b>PUNIME PRISHJE</b>				
1	An	Prishje shtrese h/izolimi	m <sup>2</sup>	1,030		
2	2.37/3b	Transport materiale ndërtimi me auto deri 8 km	m <sup>3</sup>	17		
<b>II</b>		<b>PUNIME SHTRESASH</b>				
1	2.264	Shtresë llustër çimento	m <sup>2</sup>	2,060		
2	2.197	H/izolim tarace 2/kk	m <sup>2</sup>	1,030		
3	2.200/1	Termoizolim solete 10-20cm me polisterol	m <sup>2</sup>	1,030		
4	2.203	Veshje kornize me llamarinë xingato	m <sup>2</sup>	122		
		<b>Shuma 3 (I-II)</b>				
<b>4</b>		<b>SHKOLLA "EJONA DINGA"</b>				
<b>I</b>		<b>PUNIME PRISHJE</b>				
1	An	Prishje shtrese h/izolimi	m <sup>2</sup>	170		
2	2.37/3b	Transport materiale ndërtimi me auto deri 8 km	m <sup>3</sup>	3		
<b>II</b>		<b>PUNIME SHTRESASH</b>				
1	2.264	Shtresë llustër çimento	m <sup>2</sup>	290		
2	2.197	H/izolim tarace 2/kk	m <sup>2</sup>	170		
3	2.200/1	Termoizolim solete 10-20cm me polisterol	m <sup>2</sup>	145		
4	2.203	Veshje kornize me llamarinë xingato	m <sup>2</sup>	50		
		<b>Shuma 4 (I-II)</b>				
		<b>SHUMA TOTALE PA TVSH (1+4)</b>				
		<b>TVSH 20%</b>				
		<b>SHUMA TOTALE ME TVSH (1+4)</b>				

**Shtojca 14.**

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>4</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimet Publike”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< **Emri** >

---

<sup>4</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

**Shtojca 15**

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

**Shtojca 16**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_





## Shtojca 17

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët –Kërkesë për propozim**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv për njësi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njësi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon në objektin e kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikrat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkonsulentit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkonsulentin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkonsulentin një dispozitë që premtonte ruajtjen e kofidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë

## Dokumenta Standarde të Tenderit

zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

### **Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

### **Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

### **Neni 9: Komunikimi**

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

### **Neni 10: Bashkepunimi në Kantier me të Tjerët**

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkepusojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

### **Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

### **Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

### **Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.

13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve**

14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhë atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

### **Neni 15: Ngritja e Kantierit**

15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

